

Përmbledhje e politikave Nr. 2.



Programi Y - Dëshmitë dhe implikimet

Përmbledhja e politikave të programit Y ofron informacion mbi rëndësinë e paraqitjes së programeve bazuar në zhvillimin e shkathtësive të jetesës dhe një përmbledhje të rezultateve kryesore të arritura përmes zbatimit të programit gjithëpërfshirës të promovimit të shëndetit dhe parandalimit të dhunës - Iniciativa e Burrave Të Rinj. Rezultatet e paraqitura në këtë dokument janë nxjerrë nga studimet e vlerësimit të kryera në Serbi, Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci dhe Kosovë.

Adoleshentët kanë nevojë për shkathtësi të jetesës

Adoleshenca është një periudhë kalimtare e zhvillimit intensiv psikofizik. Gjatë kësaj periudhe, adoleshentët kanë aftësi shumë të theksuara intelektuale, fizike dhe të tjera, por edhe sjellje të caktuara anti-sociale dhe zakone jo të shëndetshme që mund të zvogëlojnë këto aftësi dhe të lënë pasojë afatgjatë ose të përrjetshme mbi ta, jetën e tyre, si dhe komunitetet në të cilat ata janë rritur¹. Programi Y dhe klubi Bëhu Burrë kontribuojnë në zhvillimin e shkathtësive të jetesës që u mundësojnë të rinjve të kapërcejnë vështirësitë me të cilat mund të përballen, por gjithashtu i motivojnë të rinjtë të zgjerojnë ndikimin e tyre tek bashkëmoshatarët e tyre jashtë shkollës, dhe kështu të shtrijnë ndikimin e tyre në komunitete dhe shoqërinë në të cilën ata jetojnë.

1 — GESJ: Shkenca dhe Psikologjia e Edukimit. (2011). Edukimi për shkathtësitë e jetesës për adoleshentët: Rëndësia dhe relevanca e saj

Vlen të theksohet:

- 1** Programi Y është një kurrikulë arsimore e bazuar në shkencë, e përshtatur për nevojat specifike të të rinjve, e cila u mundëson të rinjve që të përballen në mënyrë të pavarur dhe me shkathtësi të përshtatshme me sfidat e rritjes, duke marrë vendime që janë më të rëndësishme për shëndetin e tyre.
- 2** Edukimi cilësor sipas metodologjisë së Programit Y, nëse zbatohet me mbështetje sistematike dhe në një mjedis mbështetës, mund të çojë në ndryshim në qëndrimet dhe sjelljet e të rinjve, t'i motivojë ata të kujdesen për shëndetin e tyre dhe shëndetin e bashkëmoshatarëve të tyre, të inkurajonë këmbënguljen në marrjen e vendimeve që janë në interesin më të mirë të shëndetit të tyre.
- 3** Programi Y çon në zvogëlim të dhunës fizike, një rritje të barazisë gjinore, rritje të tolerancës, ulje të incidencës së dhunës digjitale dhe rritje në përqindjen e të rinjve që do të ndalonin dhunën që po e shohin.
- 4** Staf i mësimor dhe publiku profesional i përfshirë në auditimin dhe zbatimin e Programit Y njohin metodologjinë si një program arsimor cilësor dhe i rëndësishëm.

Përmbledhje e politikave Nr. 2.

Programi Y - Dëshmitë dhe
implikimet

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Sipas përkufizimit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, *Shkathtësitë e Jetesës janë aftësi për sjellje adaptive dhe pozitive që u mundësojnë individëve të trajtojnë në mënyrë efektive kërkesat dhe sfidat e jetës së përditshme*. Edukimi i bazuar në shkathtësi jetësore kërkon t'u ofrojë studentëve strategji për marrjen e vendimeve të shëndetshme që kontribuojnë në një jetë kuptimplotë. Shkathtësitë e jetesës si bazë e veprimit përshkohen përmes programit kurrikular Y dhe aktiviteteve të Klubit Bëhu burrë.

Çfarë dimë?

Qasjet tradicionale arsimore për promovimin e shëndetit bazuar në informimin e studentëve për rreziqet dhe pasojat e stileve të pashëndetshme të jetesës nuk janë efektive dhe nuk u shërbejnë nevojave të brezit aktual^{2,3}.

Trendet e reja mes të rinjve, rrjetet sociale dhe masmedia gjithashtu kanë ndikuar në ndryshimin e qëndrimeve mes të rinjve. Hapësira virtuale është bërë një vend për grumbullimin, socializimin, shkëmbimin e informacionit, por edhe hapësirë ku ka faktorë të rinj që ndikojnë në qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e të rinjve që kontribuojnë në shfaqjen e faktorëve të rinj të rrezikut.

Duke përdorur metoda të ndryshme kërkimore, CARE International Balkans dhe partnerët e saj analizuan nevojat dhe sjelljet e të rinjve, nevojat e shkollave, prindërve dhe komuniteteve lokale, dhe në përputhje me gjetjet, krijuan një përgjigje gjithëpërfshirëse arsimore të bazuar në dëshmi.

Parandalimi i dhunës, parandalimi i zakoneve jo të shëndetshme të të rinjve, parandalimi i HIV-it dhe transmetimi i infeksioneve seksualisht të transmetueshme dhe mbrojtja e shëndetit mendor janë ndër prioritetet kryesore të vendeve në rajonin e Ballkanit. Në përpjekjet e tyre për t'iu përgjigjur sfidave shëndetësore të adoleshentëve dhe për të kontribuar në ruajtjen e shëndetit të të rinjve, vendet e Ballkanit po marrin masa të ndryshme, përfshirë qasjet programatike të institucioneve shëndetësore dhe arsimore. Fatkeqësisht, ka një mungesë të qasjeve të sinkronizuara dhe gjithëpërfshirëse dhe zgjidhjeve të sistemit që do të ofronin një përgjigje sinergjike dhe më efektive.

2 – Organizata Botërore e Shëndetësisë, Gjenevë. (1999). Partnerët në edukimin për shkathtësitë e jetesës, Konkluzionet nga takimi midis agjencive të Kombeve të Bashkuara

3 – Qendra për kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve. (2020) Karakteristikat e një kurrikule efektive të edukimit shëndetësor burimi në internet: <<https://www.cdc.gov/healthyschools/sher/characteristics/index.htm>>

Rekomandimet ndërkombëtare të integruara në modelin e punës për të rinjtë

Është e nevojshme t'i ofrohet të rinjve qasje në programet pjesëmarrëse që i vendos ata në qendër të të mësuarit, dhe e cila, përveç njohurisë funksionale, kontribuon në zhvillimin e shkathtësive të jetesës që janë esenciale për vendim-marrje që janë në interesin më të mirë të shëndetit të tyre. Shkathtësitë janë aftësi, kështu që është e rëndësishme t'i mundësohet të rinjve të adoptojnë dhe praktikojnë ato në një mjedis formal. Vetë-besimi, socializimi, dhe toleranca nuk janë shkathtësi, por përvetësimi i këtyre cilësive lehtësohet përmes të mësuarit dhe praktikimit të shkathtësive të jetesës siç janë vetëdijësimi, zgjidhja e problemeve, të menduarit kritik, dhe shkathtësitë ndërpersonale⁴.

Shkollat janë mjedisi më i rëndësishëm për të rinjtë. Duke pasur parasysh që më shumë të rinj i vijojnë shkollat, shkollat janë vendi më relevant për edukimin formal, ndërtimin e shkathtësive jetësore, ndërtimin e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët dhe të mësuarit rreth zgjidhjes së konflikteve dhe problemeve me të cilat ata mund të ballafaqohen gjatë kohës që ata rriten⁵.

Edhe pse adoleshentët janë një popullsi përgjithësisht e shëndetshme, zakonet dhe sjelljet gjatë kësaj periudhe mund të ndikojnë ndjeshëm në shëndetin dhe cilësinë e jetesës së tyre në jetën e mëvonshme. Dhuna, lëndimet, përdorimi i alkoolit dhe drogës, shëndeti mendor i dëmtuar dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme janë problemet më të zakonshme shëndetësore të të rinjve⁶, si në botë ashtu edhe në vendet e Ballkanit. Shkollat dhe edukimi zyrtar ofrojnë mundësi të konsiderueshme dhe mundësi për të arritur një numër të madh të të rinjve përmes edukimit shëndetësor dhe stilit të jetesës së shëndetshme, të cilat nuk mund të arrihen brenda mjediseve shëndetësore që të rinjtë rrallë ndjekin.

4 – Organizata Botërore e Shëndetësisë, (1999). Partnerët në edukimin për shkathtësitë e jetesës, Konkluzionet nga takimi midis agjencive të Kombeve të Bashkuara

5 – Organizata Botërore e Shëndetësisë. (2020). Manual shkollorë edukativ për shkathtësitë e jetesës Parandalimi i sëmundjeve jo ngjithëse

6 – Organizata Botërore e Shëndetësisë. (2018) Adoleshentët: rreziqet dhe zgjidhjet shëndetësore, më shumë informacion në: <<https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/adolescents-health-risks-and-solutions>>

Përmbledhje e politikave Nr. 2.

Programi Y - Dëshmitë dhe implikimet

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Programi Y dhe klubi Bëhu Burrë përfaqësojnë një model gjithëpërfshirës të të punuarit me pjesëmarrësit e shkollave të mesme, dhe në fushat e identifikuara përmes hulumtimit të Ballkanit dhe rekomandimeve ndërkombëtare si më të rëndësishmet për këtë grupmoshë. Të dy modelet u ofrojnë të rinjve mundësinë për të adoptuar dhe praktikuar shkathtësitë në një mjedis të sigurt dhe pozitiv. Për të qenë efektive, programet e zhvillimit të shkathtësive të jetesës duhet të kenë rezultate të përcaktuara qartë, procesi arsimor duhet të jetë me pjesëmarrje, dhe aspektet sociale të shëndetit të integruara në mësimet⁷.

Të udhëhequr nga parimet e zbatimit të qasjeve të bazuara shkencërisht në punën me të rinjtë, në kuadër të programit Iniciativa e Burrave të Rinj, është zhvilluar një kurrikulë për punë në shkollat e mesme, Programi Y dhe një program plotësues, Klubi Bëhu Burrë. Të dy programet janë zhvilluar në bashkëpunim me shkollat e mesme, ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, institucione arsimore vendore dhe ndërkombëtare dhe OJQ-të.

Efektet e edukimit sipas metodologjisë së Programit Y dhe aktiviteteve të klubit Bëhu burrë:

1. Ndryshimet në qëndrimet ndaj dhunës dhe miratimi i qëndrimeve që çojnë në tolerancë më të ulët ndaj formave të ndryshme të dhunës
2. Reduktimi i shfaqjes së dhunës fizike
3. Reduktimi i shfaqjes së dhunës digjitale
4. Reduktimi i shfaqjes së dhunës seksuale
5. Rritja e nivelit të qëndrimeve të barabarta gjinore
6. Rritje e përqindjes së të rinjve që do të ndalonin dhunën që po e shohin
7. Një numër më i madh i të rinjve që do të kërkonin ndihmë
8. Rritja e njohurive rreth dhunës, shëndetit dhe mënyrave të shëndetshme të jetesës

7 – Organizata Botërore e Shëndetësisë. (1999). Partnerët në edukimin për shkathtësitë e jetesës, Konkluzionet nga takimi midis agjencive të Kombeve të Bashkuara

Ndikimi i Programit Y dhe Klubit Bëhu Burrë në Shëndetin dhe Mirëqenien e të Rinjve

Edukimi i bazuar në metodologjinë e Programit Y, tek të rinjtë mund të çojë në ndryshim në qëndrime dhe sjellje, të ndikojë në perceptimin e të rinjve për rëndësinë e kujdesit dhe vendimmarrjes për shëndetin e tyre dhe shëndetin e bashkëmoshatarëve të tyre. Një analizë krahasuese^{8 9 10} e qëndrimeve, njohurive dhe sjelljes së të rinjve para dhe pas pjesëmarrjes në aktivitetet e programit Iniciativa e Burrave të Rinj, mbledhi dëshmi dhe implikime që theksojnë rëndësinë e futjes së Programit Y dhe aktiviteteve të klubit Bëhu Burrë në edukimin formal.

Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndetshme dhe kundërshtimi i ndikimeve negative të bashkëmoshatarëve

Duke pasur parasysh që të rinjtë në adoleshencë ndikohen fuqimisht nga bashkëmoshatarët, është e rëndësishme të theksohet se Programi Y kontribuon në të kuptuarit e ndryshimit midis marrëdhënieve të shëndetshme dhe jo të shëndetshme, dhe duke përvetësuar shkathtësi negociuese dhe komunikuese, të rinjtë janë në gjendje të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme dhe të kundërshtojnë potencialisht ndikimet e dëmshme të bashkëmoshatarëve dhe grupeve të bashkëmoshatarëve. Duke zhvilluar mendim kritik dhe duke adoptuar informacion dhe qëndrime në lidhje me përgjegjësinë personale në kontekstin e vendimmarrjes, dëshmitë tregojnë se të rinjtë zhvillojnë një shkallë më të madhe të përgjegjësisë për vendimet që marrin dhe vërehet një shkallë më e madhe e përgjegjësisë në lidhje me shëndetin dhe kujdesin shëndetësor.

Reduktimi i dhunës nga bashkëmoshatarët

Dhuna është një problem i shëndetit publik që është i pranishëm në të gjitha vendet e Ballkanit, dhe parandalimi i dhunës është në krye të prioriteteve strategjike të Serbisë, Kroacisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës dhe Shqipërisë. Të rinjtë janë një kategori veçanërisht e prekshme, dhe dhuna që ata i ekspozohen në shkollë, në komunitet dhe në mjedisin virtual mund të ketë një ndikim shkatërrues në shëndetin e tyre fizik dhe mendor. Ekspozimi ndaj dhunës ndikon në motivimin e të rinjve për të ndjekur shkollën, ndikon në arritjen e rezultateve

8 – CARE International Balkans.(2016). Djemtë dhe burrat si aleatë në parandalimin e dhunës dhe transformimin gjinor në Ballkanin Perëndimor - Iniciativa e Burrave të Rinj, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Kosovë, Shqipëri

9 – CARE International Balkans. (2017). Promovimi i stileve të jetesës më të shëndetshme mes të rinjve në Bosnjë dhe Hercegovinë duke sfiduar stereotipat gjinorë, Bosnjë dhe Hercegovinë

10 – CARE International Balkans. (2020). Burrat dhe djemtë si partnerë në promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e ekstremizmit dhe dhunës së të rinjve në Ballkan, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Kosovë, Shqipëri

Përmbledhje e politikave Nr. 2.


Programi Y - Dëshmitë dhe implikimet

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Ndërtimi i marrëdhënieve të shëndetshme dhe kundërshtimi i ndikimeve negative të bashkëmoshatarëve



dhe vendosjen e qëllimeve më të larta akademike. Vlerësimet e kryera tregojnë se Programi Y kontribuon në zvogëlimin e dhunës fizike, dhunës psikologjike, dhunës seksuale dhe digjitalë, dhe është veçanërisht e rëndësishme të theksohet se të rinjtë që kanë kaluar programin arsimor bazuar në zhvillimin e shkathtësive të jetesës sipas Modelit të Programit Y kanë më shumë kapacitet, gatishmëri dhe vetëbesim për të ndaluar dhe kundërshtuar dhunën që ata e shohin ose kërkojnë/ofrojnë ndihmë nëse ata ose bashkëmoshatarët e tyre kanë nevojë për të. Në këtë mënyrë, Programi Y kontribuon në zhvillimin e një kulture pa dhunë në nivelin e klasës, shkollës dhe komunitetit lokal, dhe ky lloj parandalimi sipas hulumtimeve globale ka implikime për ndikimin më efektiv.

Eliminimi i stereotipeve gjinore dhe rritja e nivelit të barazisë gjinore

Parandalimi i dhunës në familje, dhunës ndaj grave dhe vajzave është gjithashtu pjesë e programeve kombëtare të qeverive të vendeve ku zbatohet Programi Y. Një aspekt shumë i rëndësishëm në parandalimin është **eliminimi i stereotipeve gjinore dhe rritja e nivelit të barazisë gjinore**. Programi Y dhe klubi Bëhu Burrë drejtpërdrejt kontribuojnë në rritjen e nivelit të barazisë gjinore, i cili është gjithashtu rezultati më i zakonshëm i vërejtur gjatë shumë viteve të monitorimit të ndikimit të programit tek të rinjtë. Duke

Përmbledhje e politikave Nr. 2.


Programi Y - Dëshmitë dhe implikimet

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net


INDEKSI I ROLIT GJINOR



adoptuar shkathtësitë jetësore, veçanërisht të menduarit kritik, të rinjtë e kuptojnë më mirë ndikimin e pabarazisë gjinore mbi ta dhe bashkëmoshatarët e tyre dhe bëhen aleatë kryesorë në transformimin e mjedisit duke promovuar barazi dhe drejtësi në të gjitha sferat e jetës.

Reduktimi i përdorimit të substancave psikoaktive

Përdorimi i substancave të paligjshme psikoaktive gjatë adoleshencës mund të lërë pasojë të paparashikueshme në shëndetin mendor dhe fizik. Nga ana tjetër, përdorimi i këtyre substancave ndikon edhe në sjelljen e të rinjve në këtë moshë. Prandaj, është inkurajuese që programi tre-vjeçar ka ulur përqindjen e të rinjve që kanë përdorur substanca psikoaktive.




Respekti, toleranca, pranimi dhe ndjeshmëria ndaj të tjerëve

Mungesa e ndjeshmërisë dhe kuptimit të nevojave të të tjerëve mund të jetë një faktor vendimtar në shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike. Nga ana tjetër, mungesa e ndjeshmërisë gjithashtu kontribuon në mungesën e tolerancës ndaj të tjerëve dhe e kundërta. Analiza e ndikimit të Programit Y dhe aktivitetet e Klubit Bëhu Burrë identifikoi një rritje të konsiderueshme në nivelet e tolerancës, ndjeshmërisë dhe pranimit të grupeve të pakicave. Studimi gjithashtu ka konfirmuar një rritje të ndjeshmërisë për statusin e grave, veçanërisht kur bëhet fjalë për të drejtat dhe ekspozimin ndaj dhunës.

Respekti, toleranca, pranimi dhe ndjeshmëria ndaj të tjerëve

MË PARË MË PAS



Ruajtja e shëndetit riprodhues

Fëmijët dhe adoleshentët me dhe pa gjendje shëndetësore dhe pa aftësi kronike do të përfitojnë kur atyre u ofrohet informacion i saktë dhe i përshtatshëm për moshën mbi dimensionet biologjike, sociokulturore, psikologjike, relacionale dhe shpirtërore të seksualitetit¹¹. Megjithatë ka dëshmi të qarta se edukimi për tema të tilla si seksualiteti nuk i inkurajon të rinjtë të bëjnë seks dhe në fakt i zgjasin vendimet e të rinjve¹², ka ende rezistencë në Ballkan ndaj kësaj teme dhe temave të ngjashme. Si rezultat, të rinjtë mbeten të privuar nga arsimit cilësor dhe më së shpeshti u ofrohet atyre informacion dhe qasje që janë treguar joefektive dhe nuk kanë asnjë ndikim në qëndrimet dhe sjelljen e të rinjve.

11 – Cora C. Breuner, Gerri Mattson, Komisioni për adoleshencën dhe komisioni për aspektet psikosociale të shëndetit të fëmijës dhe familjes. (2016) Edukimi për seksualitetin për fëmijë dhe adoleshentë

12 – Qendra Federale për Edukimin Shëndetësor (BZgA), (2016). Edukimi për seksualitetin, Përmbledhje e politikave Nr. 1

Përmbledhje e politikave Nr. 2.

Programi Y - Dëshmitë dhe implikimet

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Vlerësimet tregojnë se pas edukimit sipas metodologjisë së Programit Y, të rinjtë kanë më shumë informacion në lidhje me infeksionet seksualisht të transmetueshme, më shumë kuptueshmëri se si vendimet e tyre mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në shëndetin e tyre riprodhues dhe shkathtësitë e fituara u mundësojnë atyre që të përballen në mënyrë më efektive me ndikimet sociale që janë një faktor kryesor në ruajtjen e shëndetit të tyre. Është e rëndësishme të theksohet se vlerësimet ndërkombëtare tregojnë se edukimi shëndetësor riprodhues cilësor dhe i përshtatshëm për moshën e zgjat vendimin për të bërë seks, nuk inkurajon të rinjtë të jenë seksualisht aktivë dhe u mundëson të rinjve të jenë përgjegjës për shëndetin e tyre riprodhues.

REKOMANDIMET

- Politikat edukative për shëndetin dhe parandalimin e dhunës duhet të jenë në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe t'i bëjnë programet edukative të bazuara në shkathtësitë e jetesës më të qasshme.
- Duke kryer aktivitete vlerësuese, vendet mund të analizojnë ndikimin e programit dhe të krahasojnë efektet në lidhje me praktikën në zbatimin e programit dhe të identifikojnë qasjet dhe faktorët më efektivë që kontribuojnë në një efektshmëri më të madhe.
- Me mbështetjen e ministrive të arsimit dhe pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtyre institucioneve, shkollat mund të inkurajohen të zbatojnë programe shkollore me cilësi dhe përkushtim më të lartë.
- Në mënyrë që programi të jetë i suksesshëm në arritjen e rezultateve të pritura, është e nevojshme të kryhet trajnimi i stafit mësimdhënës, në mënyrë që të zhvillohen kompetencat për zbatimin e një programi gjithëpërfshirës të parandalimit bazuar në zhvillimin e shkathtësive të jetesës.
- Të pritët dhe ofrohen përgjigje prindërve, mësimdhënësve dhe studentëve në lidhje me shqetësimet ose paqartësitë e tyre në lidhje me zbatimin e programit.
- Personeli mësimor në shkollë, pavarësisht nëse ata janë të përfshirë drejtpërdrejt në zbatimin e programit, duhet të jetë i familjarizuar me rëndësinë e edukimit të bazuar në shkathtësitë e jetesës, dhe personeli mësimdhënës i përfshirë në zbatimin e punëtorive duhet të ketë qasje në trajnim që përmirëson më tej nivelin e kompetencave të nevojshme për të zbatuar edukimin e bazuar në shkathtësitë e jetesës.
- Të afirmohet pjesëmarrja e studentëve në aktivitetet e Klubit Bëhu Burrë, me vëmendje të veçantë për përfshirjen e të rinjve që vijnë nga familje jofunksionale, të rinjve në rrezik në rritje.
- Të vendoset bashkëpunimi me organizatat vendore, institucionet, prindërit dhe të koordinohen aktivitetet e shkollës paralelisht me aktivitetet në komunitetin lokal dhe t'iu mundësohet të rinjve të propozojnë tema dhe aktivitete që janë plotësuese dhe të mund të zbatohen në kuadër të aktiviteteve të Klubit Bëhu Burrë.

Përmbledhje e politikave Nr. 2.


Programi Y - Dëshmitë dhe
implikimet

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Skema 1: Fazat e krijimit dhe zbatimit të programit Iniciativa e Burrave Të Rinj



Gjeni më shumë informata në

<https://youngmeninitiative.net> dhe <http://www.program-y.org>.

Përmbledhje e politikave Nr. 2.

Programi Y - Dëshmitë dhe
implikimet

Future 4YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

LITERATURA

Iniciativa e Burrave të Rinj (Young Men Initiative) - Programi për të promovuar barazinë gjinore, jo dhunën dhe stilet e jetesës së shëndetshme, CARE International Balkans, 2018. Linku në internet: <https://youngmeninitiative.net/wp-content/uploads/2018/09/YMI_PROGRAM-Brochure-BIH.pdf>

Bëhu burrë, ndrysho rregullat! Të gjeturat dhe mësimet e nxjerra gjatë projektit shtatë-vjeçar Iniciativa e Burrave të Rinj të organizuar nga CARE International Balkans, CARE International Balkans, 2017. Linku në internet: <https://beta.youngmeninitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/Nalazi-i-lekcije-nau%C4%8Dene-tokom-sedmogodi%C5%A1njeg-projekta-inicijativa-mladi%C4%87a-u-organizaciji-CARE-International-Balkan.pdf>

„Burrat dhe djemtë si partnerë në promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës dhe ekstremizmit tek të rinjtë në Ballkan”, Raporti i Vlerësimit të Linjës Fundore në dispozicion në <<http://www.careevaluations.org/evaluation/men-and-boys-as-partners-in-promoting-gender-equality-and-prevention-of-youth-extremism-and-violence-in-the-balkans/>>

Promovimi i stileve më të shëndetshme jetësore midis të rinjve në Bosnjë dhe Hercegovinë duke sfiduar stereotipet gjinore, Projekti "Iniciativa e Burrave të Rinj", Raporti i Vlerësimit të Linjës Fundore në dispozicion në <<http://www.careevaluations.org/evaluation/men-and-boys-as-partners-in-promoting-gender-equality-and-prevention-of-youth-extremism-and-violence-in-the-balkans/>>

www.careevaluations.org/evaluation/promoting-healthier-lifestyles-among-youth-in-bosnia-and-herzegovina-by-challenging-gender-stereotypes-ii-young-men-initiative-project-ii-yml-ii/

Programi Y (të rinjtë) – Qasjet inovative në parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe promovimin e stileve të jetesës së shëndetshme tek djemtë dhe vajzat, CARE International Balkans, 2016, në dispozicion në: <<https://beta.youngmeninitiative.net/wp-content/uploads/2017/07/Program-Y-BIH.pdf>>

Një përmbledhje sistematike narrative e edukimit të shkathtësive të jetesës: Efektiviteti, boshllëqet kërkimore dhe prioritetet, Aishath Nasheeda, Haslinda Binti Abdullah, Steven Eric Krauss & Nobaya Binti Ahmed, Gazeta Ndërkombëtare e Adoleshencës dhe Të Rinjve, Vëllimi 24, 2019 - Botimi 3

Manual shkollor edukativ për shkathtësitë e jetesës Parandalimi i sëmundjeve jo ngjitëse, Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020. Burimi në internet: <<https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/331948/9789240004849-eng.pdf?sequence=1&isAllowed=y>>

Karakteristikat e një Kurrikule Efektive të Edukimit Shëndetësor, Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020. Burimi në internet: <<https://www.cdc.gov/healthyschools/Sher/Characteristics/Index.Htm>>

Fuqizimi i Adoleshentëve me Edukim për Shkathtësitë e Jetesës në Shkollë – Programi i Shëndetit Mendor në Shkollë: A funksionin? P-834 - Efekti i edukimit të shkathtësive të jetesës në arritjet akademike të studentëve meshkuj të shkollës së mesme të vitit të parë

Edukimi i Shkathtësive të Jetesës për Fëmijët dhe Adoleshentët në Shkollë - Hyrje dhe udhëzuesi për të lehtësuar zhvillimin dhe zbatimin e programeve të shkathtësive të jetesës, OBSH/MNH/PSF/93.7 A.Rev.2 Burimi në internet: <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/63552/WHO_MNH_PSF_93.7A_Rev.2.Pdf?Sequence=1>

Edukimi për seksualitetin, Përmbledhja e politikave Nr. 1, Qendra Federale për Edukimin Shëndetësor (BZgA), 2016.

Partnerët në Edukimin e Shkathtësive të Jetesës, Konkluzione nga takimi midis agjencive të Kombeve të Bashkuara, Organizata Botërore e Shëndetësisë. Gjenevë 1999.

Manual shkollor edukativ për shkathtësitë e jetesës Parandalimi i sëmundjeve jo ngjitëse, Organizata Botërore e Shëndetësisë.2020.

Botues:

Zyra Qendrore CARE Gjermani e.V në BiH
CARE International Balkans
Hasana Kaimije 11, Sarajevë
www.care-balkan.org
www.youngmeninitiative.net
info@youngmeninitiative.net

**Për botuesin:**

Sumka Bučan, Drejtoreshë Regjionale

Emri i autorit:

Feđa Mehmedović

Redaktimi i tekstit:

GCDA Kosovë

Dizajni:

SMART Kolektiv Beograd

Viti i botimit dhe viti i printimit:

2020

CARE International ka përvojë mbi 25 vjeçare në implementimin e programit në rajonin e Ballkanit. Gjatë luftave dhe konflikteve të viteve të '90-ta, CARE në mbarë Ballkanin i është përgjigjur shkatërrimit, traumës, zhvendosjes dhe urrejtjes ndëretnike me punën e vet humanitare dhe jetë-shpëtuese. Nga viti 2000, CARE është përqendruar në punën zhvillimore dhe qëllimi i vet në Ballkan sot është të sigurohet se të drejtat e shoqërore, ekonomike dhe politike të grupeve të marginalizuara njihen dhe përmbushen, duke kontribuar kështu në paqe të qëndrueshme në rajon. Strategjia e programit të CARE bazohet në dy shtylla a) Përfshirja socio-ekonomike e komuniteteve dhe grupeve të marginalizuara duke kontribuar në kapacitete më të fuqishme dhe mundësi më të mira për ta, duke i shtyrë të integrohen në shoqëri dhe të kenë qasje në të drejtat e tyre. b) Barazia gjinore e grupeve të marginalizuara, duke promovuar vlerat dhe praktikën e barazisë gjinore, diversitetin dhe praktikën jo të dhunshme, duke fuqizuar kapacitetet e aktorëve për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë sociale në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal si dhe duke krijuar mundësi për inovacion, pjesëmarrje, mësim, bashkëpunim dhe avokim. CARE ushqen partneritetin me sektorin lokal të shoqërisë civile dhe qeveritë përkatëse të përkushtuara për të kontribuar për ndryshime pozitive në shoqëri.

Future 4 YouTH

Bashkohuni! Është koha për ndryshim!

www.youngmeninitiative.net

Mbështetur nga:**Partnerët:**